

Para zyrtareve komunale
prezantohet Ligji i ri
për Barazi Gjinore



Asociacioni i Komunave të Kosovës
Asocijacija Kosovskih Opština
Association of Kosovo Municipalities

ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS

Buletini

Publikim dymujor • Viti XII • Nr.75 • Nëntor - Dhjetor 2015

Këshilli i Kryetarëve për zgjedhi anëtarët e Komisionit të Granteve

Këshilli i Kryetarëve i Asociacionit të Komunave të Kosovës, bëri përzgjedhjen me anë të shortit të anëtarëve të Komisionit të Granteve. Në këtë takim përveç kryetarëve të Komunave mori pjesë edhe Zëvendësministri i Financave z. Agim Krasniqi.



Pas insistimit të Asociacionit të Komunave të Kosovës, ligji për dhënie e Pronës Komunale në shfytëzim dhe këmbim do të amandamentohet në vitin 2016



Task Forca e NALAS-it për Eficiencë të Energjisë u takua në Prishtinë

Këshilli i Kryetarëve debaton për shërbimin civil në nivelin lokal

Në diskutimet e Këshillit të Kryetarëve lidhur me problemet e pushtetit lokal në shërbimin civil, debatuan edhe Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikqyrës z. Luzim Alijaj dhe Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit z. Alush Istogu. Z.Luzim Alijaj, Kryetar i Këshillit të Pavarur Mbikqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMShCK), elaboroi funksionet kushtetuese/ligjore të Këshillit për mbikqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve për shërbimin civil si dhe sfidat dhe vështirësitë në zbatimin e legjislacionit për shërbimin civil nga pushteti lokal. Ndër të tjera z.Alija theksoi se KPMShCK-së ka për qëllim zbatimin e ligjit së bashku me të gjitha institucionet dhe se ky Këshill nuk vendos standarde, por vetëm bën mbikqyrjen e respektimit të procedurave që i përkasin shërbimit civil në Kosovë. Vështirësi të veçanta paraqesin paqartësitë dhe dualizmat e krijuara nga ligje të ndryshme e të cilat prekin funksionimin e shërbimit civil. Tjetër u theksua problemi me komunat



në zbatimin e vendimeve të marra nga ky këshill e të cilat janë përfundimtare, si dhe mangësitë e lëshuara nga komunat si në aspektin e rekrutimit po ashtu edhe në inicimin e procedurave disiplinore për zyrtarët e tyre. Në diskutimin e hapur rreth sfidave dhe vështirësive në zbatimin e ligjit për shërbim civil, kryetari i AKK-së z.Naim Ismajli tha se dualizmat nga ministrinë e linjës janë ato të cilat shkaktojnë problem në komuna. Ndërsa kryetari i komunës së Rahovecit z. Idriz Vehapi kërkoi që ligjet e finalizuara të jenë të qarta pasi që ka mos përputhje në mes të tyre. Pas diskutimeve edhe të kryetarëve tjerë, **Këshilli i**

Kryetarëve nxori këto konkluzione: – Në afat kohorë sa më të shkurtë të bëhet një takim në mes të Ministrisë së Arsimit dhe KPMShCK-së. – Ndryshimi i të gjitha ligjeve të cilat ndeshen me Ligjin për Shërbim Civil. – Të punohet me Kolegjiunet Profesionale të AKK-së në sqarimin e roleve në raportin Kryetar me shërbyes civil. – Ligjet që prekin apo kanë të bëjnë me pushtetin lokal të konsultohen paraprakisht me komunat. – Procedurat për nëpunësit civil të rregullohen nga ligji për shërbim civil. – Vendimet e Këshillit Mbikqyrës të zbatohen në mënyrë të vazhdueshme.

Para zyrtareve komunale prezantohet Ligji i ri për Barazi Gjinore

Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) në bashkëpunim me Organizatën Helvetas Swiss Intercooperation projektin DEMOS, organizoj takimin informativ me Kryesueset e Kuvendeve të Komunës – kryetarët e grupeve jo-formale te grave në Kuvendet e Komunave dhe zyrtarët për barazi gjinore të komunave. Po ashtu në takim ishin prezent edhe partnerët tonë, si nga institucionet ashtu edhe nga organizatat. Ky takim u organizua me qëllim të prezantimit të Ligjit të ri për Barazi Gjinore. Rekomandimet kryesore që dolën nga takimi: 1. Ligji i ri për Barazi Gjinore duhet të ju prezantohet të gjitha strukturave në komuna; 2. Aktet nënligjore që derivojnë nga ligji të nxjerren me kohë nga Agjencioni për Barazi Gjinore; 3. Nga AKK-ja dhe DEMOS-i kërkohet përkrahje, për hartim të një rregulloreje komunale që i përfshin promovimin e barazisë gjinore dhe regjistrimin e pronave në emër të gjinisë femërore; 4. Të inkurajohet udhëhesit e qeverisjes lokale, në pozitë vendim-marrëse të emërohen gjinia femërore ashtu siq kërkohet me ligj 50 % me 50 %; 5. Në katalogun e vendeve të punës, të përfshihet edhe pozita e zyrtareve për barazi gjinore.



Këshilli i Kryetarëve për zgjedhi anëtarët e Komisionit të Granteve

Këshilli i Kryetarëve i Asociacionit të Komunave të Kosovës, bëri përzgjedhjen me anë të shortit të anëtarëve të Komisionit të Granteve. Në këtë takim përveç kryetarëve të Komunave mori pjesë edhe Zëvendësministri i Financave z. Agim Krasniqi.



Duke e pasur parasysh edhe përfundimin e mandatit të kryetarëve në Komisionin e Granteve të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2015, është bërë përzgjedhja e anëtarëve të rinj të Komisionit të Granteve për vitin 2016 me mandate një vjeçar. Kjo përzgjedhje është bërë bazuar në nenin 32 pika 1, 2 dhe 3 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal. Me anë të shortit, anëtarët e rinj të Komisionit të Granteve janë përzgjedhur kryetarët nga komuna e Prizrenit, Dragashit, Klinës dhe ajo e Graçanicës. Për Komunitat e përzgjedhura sipas Zëvendësministrit të Financave z. Agim Krasniqi parashihet një takim në fillim të vitit, në të cilin do të njoftohen përfaqësuesit e këtyre komunave për rolin që do të kenë në këtë Komision dhe për procedurat e funksionimit të këtij organi.

Këshilli i Kryetarëve miratoi draft Strategjinë e Asociacionit të Komunave të Kosovës 2016-2020

Në takimin e fundit për këtë vit, Këshilli i Kryetarëve i Asociacionit të Komunave të Kosovës diskutoi dhe miratoi draft planin strategjik 2016-2020 dhe me dhënien e komenteve nga kryetarët e komunave ky dokument u procedua për shqyrtim përfundimtar nga Kuvendi i Asociacionit të Komunave të Kosovës. Këshilli i Kryetarëve, si njëri ndër mekanizmat kryesor të Asociacionit të Komunave të Kosovës debatoi lidhur me draft Planin Strategjik 2016-2020.

Një pasqyrim të draftit të këtij dokumenti me rëndësi për zhvillimin e ardhshëm katërvjeçar të Asociacionit të Komunave të Kosovës e paraqiti kryetari z.Naim Ismajli. Pas diskutimeve, Këshilli i Kryetarëve miratoi draftin e



Planit Strategjik dhe procedoi këtë dokument me rëndësi për shqyrtim përfundimtar nga Kuvendi i Asociacionit të Komunave të Kosovës i cili pritet të mbahet në fillim të vitit të ardhshëm.



Asociacioni i Komunave të Kosovës diskutoi me partnerët e vetë për Strategjinë 2020

Pjesë e debatit lidhur me Strategjinë e ardhshme 2016-2020 të Asociacionit të Komunave të Kosovës ishin edhe përfaqësuesit e organizatave partnere të AKK-së. Ky debat u organizua në takimin, tashmë tradicional "Miq të e AKK-së".

Drejtori Ekzekutiv i Asociacionit të Komunave të Kosovës z.Sazan Ibrahim duke falenderuar partnerët për bashkëpunimin e deritashëm tha se ky bashkëpunim do të duhej të shtrihet edhe gjatë zbatimit të Strategjisë së ardhshme katërvjeçare në mënyrë që komunave të Republikës së Kosovës t'u ofron më shumë shërbime dhe më shumë lobim efektiv për interesat e tyre. Z.Ibrahimi tha se Plani Strategjik i AKK-së për periudhën nga viti 2016 deri në vitin 2020 bazohet në planin e mëhershëm 2011-2015, i cili është përpunuar dhe përditësuar dhe u është përshtatur zhvillimeve të kohës së fundit. Vendimi për t'a hartuar Planin Strategjik 2016-2020 është marrë nga Bordi i AKK-së, i cili do të ketë mandat katërvjeçar.

Bordi ka vendosur që Strategjia e ardhshme t'i përshtatet kontekstit të ndryshuar që nga viti 2011, pastaj t'i vlerësojë përparësitë dhe mangësitë aktuale të organizatës dhe të nxjerrë përfundime të duhura si dhe t'i identifikojë mundësitë për të ardhmen afatmesme.

Ndërsa duke bërë një elaborim detaj të draft Strategjisë së AKK-së për periudhën 2016-2020 z.Gani Berisha – Menaxher i Programit tha se së pari, ky plan i ofron AKK-së një kornizë për strategjinë afatmesme si dhe udhëzime operative për programet vjetore të saj dhe së dyti, ky plan shërben për t'a lehtësuar komunikimin dhe bashkërendimin me partnerët kombëtarë, rajonalë dhe ndërkombëtarë me AKK-në. Ai shtoi se periudha katërvjeçare që mbullohet nga ky Plan Strategjik është thelbësore për vazhdimin e përforcimin institucional, organizativ dhe financiar të AKK-së. Poashtu z.Berisha paraqiti edhe kontekstin aktual dhe atë të ardhshëm të qeverisjes lokale në Kosovë me të cilën do të merret edhe Strategjia e AKK-së në kontek-

stin e zgjidhjes së një mori çështjeve që kanë të bëjnë me komunat tona. Në vazhdim të këtij elaborimi z. Berisha pasqyroj analizën e gjendjes edhe të Asociacionit të Komunave të Kosovës e paraqitur në draftin e Strategjisë së ardhshme dhe synimet e kësaj organizate deri në vitin 2020.

Përfaqësuesja e Agjencionit Zvicerian për Bashkëpunim (SDC), partnerit kryesor të Asociacionit të Komunave të Kosovës, znj.Saranda Cana tha se ky dokument Strategjik tregon se AKK ka ecur në hapat e tij të zhvillimit jo vetëm nga fakti i përmbushjes në masën më të madhe të orientimeve të Strategjisë së deritashme por edhe me synimet që i ka vënë vetes Asociacioni për katër vitet e ardhshme e të pasqyruara në këtë draft. Edhe përfaqësuesit e organizatave tjera partnere si USAID, GIZ, DEMOS etj. paraqiten qëndrimet e tyre lidhur me mundësitë dhe objektivat e tyre për bashkëpunim në katër vitet e ardhshme në sfera të ndryshme në mënyrë që përfituesit kryesor dhe më të mëdhenjë të jenë vetë Komunitat e Kosovës.

Asociacioni i Komunave të Kosovës draftin e Strategjisë 2016-2020 do ta debatoj edhe me Kryesuesit e Kolegjiumeve Profesionale dhe me Këshillin e Kryetarëve si njëri ndër mekanizmat kryesor të tij.

Pas insistimit të Asociacionit të Komunave të Kosovës, ligji për dhënien e Pronës Komunale në shfytëzim dhe këmbim do të amendamentohet në vitin 2016

Në takimin e fundit të Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik (KKZHE), z. Sazan Ibrahim, drejtor ekzekutiv i Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK) ngriti edhe një herë shqetësimin rreth problemeve që është duke sjellë ligji për dhënien e Pronës Komunale në Shfytëzim dhe Këmbim si dhe pasojat që ky ligj është duke sjellë në mos-zhvillimin ekonomik lokal dhe kërkesën e komunave për fillimin e amendamentimit të këtij ligji. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), përkundër kërkesave të njëpasnjëshme të komunave dhe AKK-së, në strategjinë legjislative për vitin 2016 plotësim-ndryshimin e këtij ligji nuk e kishte paraparë mirëpo, pas insistimit të AKK-së në takimin e sotëm dhe takimeve tjera, ky ligj do të hyjë në strategjinë legjislative për plotësim ndryshim në vitin 2016. **Ky propozim është miratuar unanimitisht nga të gjithë anëtarët e KKZHE-së.** Duhet theksuar që KKZHE kryesohet nga z. Isa Mustafa, Kryeministër I Republikës së Kosovës (I cili poashtu ishte prezent në takimin e sotëm kur u miratua vendimi) dhe është I përbërë nga ministrat e ministrive të ndryshme që prekin fushën e Zhvillimit Ekonomik dhe përfaqësuesit e bizneseve. Ky është edhe një suksese I rradhës për komunat e Republikës së Kosovës dhe Asociacionit të Komunave të Kosovës si përfaqësues legjitim i tyre. Një pjesë e paraqitjes së z. Sazan Ibrahim në takimin e sotëm rreth kësaj çështje është në vazhdim: Përkundër angazhimeve të AKK-së dhe komunave asgjë e re nuk



është duke ndodhur në fillimin e procedurave për plotësim ndryshimin e ligjit për dhënien e Pronës Komunale në shfytëzim dhe këmbim. E kemi theksuar që plotësim ndryshimi I këtij ligji do të eliminojë të gjitha barrierat dhe burokracinë e panevojshme rreth dhënies së pronës komunale në shfrytëzim për investitorët potencial të huaj dhe vendor e në veçanti për diasporën tonë. Këto brenga të argumentuara përmes koncept dokumentit i kemi adresuar dhe paraqitur edhe në KKZHE. Ne e kemi theksuar dhe po e theksojmë përsëri se komunat vlerësojnë që ky ligj ka ndikuar në masë të madhe në mos-joshjen e investitorëve potencial vendor por edhe ndërkombëtar rreth investimeve të mundshme në komunat e Kosovës. Në bazë të informatave që ne si AKK i posedojmë, dhe te cilat informata janë të kësaj jave dhe të pranuar nga zyra ligjore e Kryeministrit, Ministria e

Amdnistrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), përkundër premtimeve të dhëna, nuk e ka paraparë plotësim-ndryshimin e këtij ligji as në vitin 2016. Pra, edhe një herë MAPL nuk e ka paraparë ne strategjinë legjislative për vitin 2016 plotësim ndryshimin e këtij ligji. Që sa kohë komunat kërkojnë që ky ligj të ndryshohet. Çështjen e plotësim ndryshimit të këtij ligji e kemi ngritur me përfaqësues politik dhe ekzekutiv të MAPL ne takimin e këshillit të kryetarëve në kuadër të AKK-së. Mendojmë që është koha e fundit që MAPL të reflektojë pozitivisht dhe t'I marrë në konsiderat brengat dhe nevojat e komunave sa i përket ZHEL dhe ndryshimit të këtij ligji. Prandaj, kërkojmë edhe një herë nga ky këshill të diskutoj me zyrtarët e MAPL-së në mënyrë që ky ligj të përfshihet në strategjinë legjislative për vitin 2016 për plotësim ndryshim.

Këshilli i Kryetarëve të Asociacionit të Komunave mbajti takim me temën “Trajtimi i problemit me qentë endacak”



Konkluzat e dalura nga takimi Këshillit të Kryetarëve të Asociacionit të Komunave të mbajtur me temën “Trajtimi i problemit me qentë endacak”.

Në këtë takim u konkludua që: Situata në komunat e Kosovës është alarmante me tendencë të përkeqësimit edhe të mëtutjeshëm gjatë sezonit të dimrit. Nevojiten hapa praktik e në parandalimin e kësaj situatë.

Komunat kërkojnë përkrahje financiare nga niveli qendror në këtë aspekt e jo vetëm përkrahje morale.

Komunat nuk mund të fajsohen për situatën aktuale rreth trajtimit të qenve endacak sepse edhe niveli qendror duhet të jetë më i përkushtuar sa i përket kësaj situatë.

Qeveria e Kosovës duhet të ndjekë situatën me shumë vëmendje dhe të fillojë të mendojë për krijimin e një fondi të veçantë për trajtimin e këtij fenomeni

Qeveria e Kosovës në bashkëpunim me Komunat duhet të fillojnë me masa të menjëhershme në parandalimin dhe eliminimin e dukurive të cilat mund të sjellin edhe hum-

bje të jetëve të qytetarëve të Kosovës ashtu siç kanë ndodhur viteve të kaluara.

Këto masa duhet të ndërmerren sa më shpejt që është e mundur e jo të pritet deri në fillimin e dimrit ku vlerësohet që qentë endacak mund të jenë shumë më të rrezikshme për jetën e qytetarëve e në veçanti të fëmijëve.

Në planin afat mesën, komunat kërkojnë që të krijohet një mekanizëm ndër-institucional i nivelit qendror dhe atij lokal për trajtimin e këtij fenomeni Kërkohet të rishqyrtohet legjislacioni që ka të bëjë me trajtimin e qenve endacak

Kryetarët konstatuan që nuk kanë burime financiare që të ndërtojnë qendra të strehimit ku do të trajtoheshin qenët endacak sepse kostoja financiare është shumë e lartë dhe e papërbalueshme për komunat (70 EUR për një qen brenda 10 ditëve duhet të harxhohen në një qendër strehimi për qentë endacak). Gjithashtu, në planin afat gjatë kjo zgjidhje nuk është e mundur për komunat e Kosovës bazuar në buxhetet komunale dhe përvojat e mëhershme të komunave rreth trajtimit të qenëve endacak.

LAJME NGA KOMUNAT

U mbajti debati me temën “Kontributi i të rinjëve dhe të rejave në politikat komunale”

Rrjeti i Edukatorëve Bashkëmoshatar (PEN), në mbështetje nga Fondacioni Ndërkombëtar për Sistem Zgjedhor (IFES) dhe Agjencioni i Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), sot në kuadër të projektit “Angazhimi i rinisë në procese politike dhe zgjedhore” në Gjakovë ka organizuar debat publik me temën: “Kontributi i të rinjëve e të rejave në politikat komunale”. Në kontekst të temës së debatit, Meriton Ferizi, drejtor i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Komunën e Gjakovës, ka sjellur shembullin e tij personal se si një person apolitik e mban një post politik, në mandatin e tij të cilin që dy vite e mban në qeverisjen locale. Drejtori Meriton Ferizi, gjithashtu ka treguar edhe për punën e Këshillit Rinor, si dhe për hartimin e planit të veprimit rinor lokal të Gjakovës, prej nga do të bëhet buxhetimi i saj në jetësimin e, të paktën projekteve më favorizuese për rininë të cila janë përfshirë në këtë plan. Dorina Lluka, nga organizata GWA -YMCA, kë treguar se kjo organizatë brenda një viti ka punuar me katërqind të rinjë të komunës së Gjakovës. Arbër Xhara, përfaqësues në Qendrën Rinore, ka kujtuar se kjo qendër vepron që nga viti 2000, dhe se merret me punën e vullnetarëve dhe promovimin e tyre, e gjithashtu në fokus ka edhe punësimin e të rinjëve Ndërkaq, Dorina Doli, kryetare e Këshillit të Nxënësve të Gjakovës ka pohuar se ky këshill është i lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me interesat që i kanë nxënësit, përderisa Arbenita Krasniqi, përfaqësuese e Këshillit Rinor Kosovar, ka theksuar se ky këshill merret me fuqizimin e të rinjëve dhe cilësinë në arsim.

LAJME NGA KOMUNAT**Në Gjilan nis implementimi i platformës “Ora e Kodimit” me synim nxitjen e të rinjve për shkencat kompjuterike**

Gjilani i është bashkangjitur sot eventit global “Ora e Kodimit”, i cili implementohet në 180 shtete të botës dhe në të cilin marrin pjesë mbi 100 milionë njerëz, përfshirë edhe presidentin e SHBA-ve, Barack Obama, themeluesin e rrejtit social Facebook, Mark Zuckerberg etj.

“Orën e Kodimit” e cila ka nisur në shkollën e mesme të gjimnazit “Xhavit Ahmeti” dhe që implementohet nga “Almooc”, e ka mbështetur kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, i cili edhe ishte pjesëmarrës në këtë ngjarje në mesin e shumë të rinjve, koderë gjilanas.

Armend Ukshini, përfaqësues nga “Almooc”, është shprehur se “Ora e Kodimit” është një mundësi e jashtëzakonshme që ky mësim të nxitet tek të rinjtë, për të shtuar se është një rrotë e madhe po lëviz në drejtim të shkencave kompjuterike.

Nga ana e tij, kryetari Haziri tha se Gjilani është Komuna e parë që e ka nënshkruar marrëveshjen me “Almooc”, në kuadër të përpjekjeve të Komunës tona për të pasur qasje sa më shumë në teknologji informative.

“Jam i nderuar që marrë pjesë në këtë iniciativë globale. Ne i kemi përzgjedhur që gjimnazistët të jenë pjesë e saj, në kuadër të përpjekjeve tona për të pasur qasje sa më shumë në teknologji informative, edhe si administratë edhe si Komunë. Gjilani është Komuna e parë që e ka nënshkruar marrëveshjen me “Almooc” dhe ne jemi partner aktiv i tyre. Duke u bërë pjesë e kësaj iniciative, besoj shumë që do të jeni pjesë e IT në nivel global. Sot, ai që s’di ta përdorë teknologjinë njihet si analfabet sepse nuk ka qasje në informacionet globale”, tha Haziri.

Më pas, në mesin e shumë të rinjve gjimnazistë, koder është bërë edhe kryetari Haziri, i cili edhe është certifikuar në fund nga “Almooc”.

LAJME NGA KOMUNAT**Këshilltarët komunalë të Podujevës ndoqën trajnimin treditor**

Këshilltarët e Kuvendit Komunal të Podujevës kanë ndjekur një trajnim treditor të organizuar në kuadër të programit të DEMOS (Decentralizimi dhe Përkrahje Komunale) me përkrahjen e Helvetas

Swiss Intercooperation – Kosovë dhe Asociacionit të Komunave të Kosovës.

Gjatë këtij programi janë trajtuar dhe është debatuar për temat që kanë të bëjnë me buxhetin komunal, menaxhimin e financave publike dhe auditmin.

Këshilltarët janë informuar dhe kanë diskutuar për Kornizën ligjore të menaxhimit të financave publike; përgjegjësinë e institucioneve lokale e qendrore në menaxhimin me financat publike; burimet e të hyrave të buxhetit komunal; planifikimi dhe menaxhimi i buxhetit komunal, korniza afatmesme buxhetore; buxhetimi gjinor dhe transparent; zhvillimi dhe analiza e planit të prokurimit, rrjedhës së parave dhe planit për investime kapitale; auditivi, monitorimi dhe mbikëqyrja e realizimit të buxhetit.

Temat e trajtuara në kuadër të këtij programi kanë zgjuar interesimin e këshilltarëve, të cilët kanë qenë pjesëmarrës aktiv në debate.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Mehmet Gashi, trajnimin e vlerësoi të dobishëm dhe me interes për këshilltarët komunal.

LAJME NGA KOMUNAT**Kryetari i komunës raportoi para qytetarëve punën e tij për vitin 2015**

Kryetari i komunës prof.dr. Ramadan Muja, raportuar para qytetarëve, OJQ-ve dhe medieve për të arriturat dhe realizimin e projekteve gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2015.

Gjatë vitit 2015, kemi realizuar projekte të shumta në interes të qytetarëve dhe jemi angazhuar fuqishëm për përmirësimin e mirëqenies së tyre.

Para qytetarëve raportoi edhe drejtori i financave, Ertan Simitçi, ai i bujqësisë Pal Geci, dhe drejtori i shërbimeve publike, Hasan Hasani.

Drejtorja e Shërbimeve Publike, ka volumin më të madh të angazhimeve në qeverinë lokale dhe me mjaft sukses po e përmbyll vitin me projekte të shumta në rregullimin e infrastrukturës rrugore, menaxhimin e mbeturinave, shtimin e kapaciteteve të ujit për pije etj..

Ndërkaq, një pjesë e qytetarëve të pranishëm lavdëruan punën e ekzekutivit komunal: Fehim Krasniqi nga Nasheci, paraqiti shqetësimin rreth ujërave të zeza në këtë lokalitet. Elhame Imami dhe Ramadan Gashi, paraqiten kërkesën e tyre për ndërtimin e një shtëpie për të moshuarit, ndërsa Asllan Ndrecaj, nga Malësia e Re kërkoi që të rregullohet në tërësi rrjeti i kanalizimit në lokalitetin ku ai jeton dhe rregullimin e një trotuari.

Pas kërkesave të qytetarëve tanë, sqaruar ne detaje projektet e mundshme dhe premtuan angazhim maksimal për realizimin e tyre.

Task Forca e NALAS-it për Eficiencë të Energjisë u takua në Prishtinë

Anëtarët e Task Forcës së NALAS-it për Eficiencë të Energjisë u mbledhën në Prishtinë për të diskutuar një nga temat me prioritet më të lartë në agjendën e saj, legjislacionin e BE-së për masat e eficiencës së energjisë në nivel lokal në Evropën Juglindore. Grupi diskutoi mundësitë për ta përshtatur legjislacionin e BE-së për implementim në nivel lokal me synim specifikat rajonale dhe kombëtare. Shkëmbimi rajonal dhe transferimi i njohurive nga anëtarët e BE-së tek Asociacionet jo partnere të BE-së në fusha si transpozimin e direktivave të BE-së në Eficiencë të Energjisë, ndërlihdjen e Planeve Kombëtare të Veprimeve për Eficiencë të Energjisë me Planet e Veprimit të Energjisë së Qëndrueshme të Autoriteteve Lokale, menaxhimi i energjisë dhe certifikimi i energjisë janë ndër temat me interes të lartë për punën e Task Forcës. Poashtu ngritja e vetëdijes së vendimmarrësve mbi rëndësinë e masave të eficiencës së energjisë në nivel lokal, si dhe motivimi i qytetarëve për të përmirësuar eficiencën e energjisë ishin ndër faktorët më të rëndësishëm për sukses në nivel lokal të listuara nga anëtarët e Task Forcës.



Takimi me Kryetarin e Komunës së Prishtinës



Konkluzionet e takimit dhe hapat e mëtejshëm

- Në të gjitha dokumentet dhe produktet e TFE-së, si një komponent i rregullt duhet të ceken burimet e financimit të BE-së për zbatimin e aktiviteteve të rekomanduara, politikat, iniciativat, etj. - Një prej takimeve të ardhshme të TFE-së do të mbahet në Kroaci. - Inkurajimi i shkëmbimit të përvojës në transpozimin e legjislacionit të BE-së dhe lidhjes së NEEAP-it me SEAP-in. - Krijimi i mundësisë së rritjes së vazhdueshme të ndërgjegjësimit në mesin e vendimmarrësve mbi eficiencën e energjisë – duke ju ofruar AQL-ve metodologjinë, shkëmbimin e përvojave, shembuj të bashkëpunimit ndër-komunal. - Duke ju ofruar AQL-ve rekomandime mbi adresimin e mungesës së kapacitetit për zbatimin e masave për eficiencë të energjisë në nivel lokal. - Këshilla dhe lobim për miratimin e kërkesave minimale për masat e eficiencës së energjisë në ndërtesat publike në Evropën Juglindore. - Shikimi i mundësive, instrumenteve dhe metodologjive për monitorimin dhe raportimin e zbatimit të SEAP-it. - Duke ju ofruar AQL-ve arsyeshmërinë për t'i motivuar komunat të aplikojnë për projekte për eficiencë të energjisë.

Anëtarët e Task Forcës së NALAS-it për Eficiencë të Energjisë kanë vizituar komunën e Prishtinës ku patën mundësinë të njoftohen nga vetë kryetari i Komunës së Prishtinës rreth arritjeve të fundit të komunës në sektorin e eficiencës së energjisë. Z. Shpend Ahmeti i njoftoi anëtarët e Task Forcës së Eficiencës së Energjisë me iniciativat të reja dhe të vazhdueshme komunale për përmirësimin e funksionimit dhe efektivitetin e objektit të ngrohtores qendrore, masat për modernizimin e transportit publik, futjen e metodës së integruar në promovimin ke masave për eficiencë të energjisë si në ndërtesat publike ashtu edhe në ato banuese gjatë gjithë ciklit të ndërtimit, duke filluar nga pjesëmarrja a qytetarëve përmes planifikimit të stimujve për ndërtim eficient të energjisë dhe renovimin e ndërtesave ekzistues. Në të vërtetë zhvillime ambicioze dhe mbresëlënëse! Ahmeti gjithashtu theksoi rëndësinë e shkëmbimit rajonal dhe të mësuarit 'peer-to-peer', ku njohuritë e fituara janë për të mirën e pushtetit lokal.

ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS

BULETINI

Viti XII. Nr. 75 • Nëntor - Dhjetor 2015

Tel: 038 245-734; Fax: 038 245-733

E-mail: info@komunat-ks.net

Web: www.komunat-ks.net

AKK-ja ka statusin e vëzhguesit në Kongresin e Autoriteteve Lokale dhe Rajonale në Evropë të Këshillit të Evropës. Është Anëtar i Përhershëm i NALAS-it (Rrjeta e Asociacioneve të Autoriteteve Lokale të Evropës Juglindore), anëtar i Rrjetit LOGIN, anëtar i Rrjetit LOGON. Anëtar në pozitën Asociacion i Ftuar (i ngjashëm me pozitën e anëtarit vëzhgues) në Komitetin Evropian të Komunave dhe Regjioneve (CEMR) si dhe anëtar në ALDA (Asociacioni i Agjensive për Demokraci Lokale).

